



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË



SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Korrik 2016

Çfarë ka të Re në SHUKALB

SHUKALB Hap Regjistrimet për Kursin e Trajnimit "Plani i Biznesit për Përmirësimin e Performancës"



Në vijim të zhvillimit të kurseve të trajnimit, kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se në fillim të muajit shtator SHUKALB do të nisë ciklin e kursit të trajnimit "Plani i Biznesit për

Përmirësimin e Performancës".

Ky kurs trajnimi është vecanërisht i vlefshëm për drejtuesit e departamentit ekonomik, inxhinierik, shitjes dhe shërbimit me klientin.

Ne ju inkurajojmë që të nxitoni të regjistroheni, pasi në këtë raund të parë do të marrin pjesë vetëm **15 shoqëri ujësjellës kanalizime!**

Për më tepër informacion ju lutem lexoni [Broshurën](#).

SHUKALB Fiton Grant nën Programin e Ujit për Danubin



SHUKALB kohët e fundit fitoi një grant nën Programin e Ujit për Danubin bazuar në projekt

propozimin me titull "Zhvillimi i Kornizës së Kurrikulës të një Programi Trajnimesh Menaxhimi për Menaxherët e Shoqërive Ujësjellës Kanalizime në Rajonin e Danubit". SHUKALB, në kuadër të Projektit të saj aktual të financuar nga USAID, po zhvillon një gamë të plotë të kurseve të trajnimit që trajtojnë



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike!

**2-3-4 Nëntor 2016,
Tiranë, Shqipëri**

Eventet e Ardhshme!

Plani i Biznesit për

kryesisht aspekte të operimin teknik, mirëmbajtjes dhe menaxhimit të shoqërive ujësjellës kanalizime. [lexo më shumë](#)

Uji dhe Punësimi, Konferenca dhe Ekspozita e 4-t e Përbashkët Ballkanike



SHUKALB dhe SHUKOS ju ftojnë të merrni pjesë në Programin e Konferencës dhe Ekspozitës së katërt të Përbashkët Ballkanike, e cila do të mbahet në Tiranë, Shqipëri, në datat 2-4 Nëntor 2016, në Ekspo City Albania. Konferenca me temë “Uji dhe Punësimi” sjell në vëmendje sfidat e shumta me të cilat po përballlet sektori i ujit duke u përpjekur të zëvendësojë forcën punëtore në prag pensioni, ndërkohë që përpiqet të komunikojë mundësitë për karrierë që ekzistojnë në sektorin e ujit, por që nuk janë të mirë kuptuara nga gjeneratat e reja në Ballkanin Perëndimor. [lexo më shumë](#)

Projekti “Zhvillimi Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri”

Projekti “Zhvillimi Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri” Organizon Mbledhjen e pestë të Grupit të Punës



Në vazhdimin e përpjekjeve për krijimin e një Programi Certifikimi Bazuar në Testim për Menaxherët Operacionalë në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

në Shqipëri, Projekti dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës organizuan takimin e pestë të Grupit të Punës. Takimi u zhvillua më 9 qershor, në ambientet e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë të sektorit të ujit, si Enti Rregullator i Ujit, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, si dhe Grupi Këshillimor Teknik, i cili përbëhet nga një grup i zgjedhur të Drejtorëve të Shoqërive Ujësjellës Kanalizime. [lexo më shumë](#)

Përmirësimin e Performancës - Shtator 2016

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



Lajme nga Anëtarët tanë

UK Korçë Fiton Grant nën Programin e Ujit për Danubin



Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime e Korçës (UK Korçë), anëtare e SHUKALB, kohët e fundit fitoi një grant nën Programin e Ujit për Danubin. Granti i është dhënë UK Korçë përmes një procesi konkurrues propozimesh për një propozim të titulluar “Përmirësimi i

Cilësisë së Shërbimeve dhe Efiçencës nëpërmjet Implementimit të një Sistemi të Monitorimit GIS dhe një Fushate të Gjerë Informuese në Zonën e re të Shërbimit Rajonal”. [lexo më shumë](#)

Të tjera

ADKOM Organizon Konferencën e 5-të Ndërkombëtare



Shoqata e Ofruesve të Shërbimeve Publike të Republikës së Maqedonisë (ADKOM), si dhe Ndërmarrja Publike Ujësjiellës Kanalizime e Shkupit, mbajtën

Konferencën e 5-të Ndërkombëtare me titull “Rregullimi i Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve”, më 25-28 maj, në Hotel Metropol , Ohër, Maqedoni. [lexo më shumë](#)

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,
Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqipëri
Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782
E-mail: info@shukalb.al, Web: www.shukalb.al